




REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVO



KOMUNA E GJILANIT
OPŠTINA GNJILANE
MUNICIPALITY OF GJILAN
GILAN BELEDIYESI

Njësia e Prokurimit

Gjilan, me datë: 31.07.2023

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Gjilanit, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit mbi Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 63 paragrafi 1.1 pika (a) të lidhur me nenin 62.1 pika (a) të Rregullorës Nr. 001/2022 për Prokurim Publik, duke vendosur sipas kërkesës për ri-shqyrtim të datës **26.07.2023** të parashtruar nga Operatori Ekonomik **“INTRAST” SH.P.K.** për aktivitetin e prokurimit me titull: **“Sinjalizimi Horizontal, Vertikal dhe pajisjeve rrugore në komunën e Gjilanit”** me Nr. të Prok: 651-22-10313-2-1-1, mori këtë:

VENDIM

- I. **HEDHET** si e palejuar Kërkesa për Rishqyrtim e Operatori Ekonomik **“INTRAST” SH.P.K.** me seli në Prishtinë e parashtruar me datë 26.07.2023 kundër Njoftimit për Vendimin të AK-së, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **“Sinjalizimi Horizontal, Vertikal dhe pajisjeve rrugore në komunën e Gjilanit”** me Nr. të Prok: 651-22-10313-2-1-1, inicuar nga AK Komuna e Gjilanit.
- II. **VËRTETOHET** Njoftimi mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues i dt. 21.07.2023 për aktivitetin e prokurimit **“Sinjalizimi Horizontal, Vertikal dhe pajisjeve rrugore në komunën e Gjilanit”** me Nr. të Prok: 651-22-10313-2-1-1, dhe AK – Komuna e Gjilanit vendosë të vazhdojë më tutje me procedurën e prokurimit të përcaktuar si në pikën një dhe dy të këtij vendimi.
- III. **NJOFTOHET** operatori ekonomik **“INTRAST” SH.P.K.** si dhe të gjitha palët tjera të interesuara lidhur me këtë vendim përmes publikimit në platformën elektronike në adresën <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.
- IV. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

A r s y e t i m

Operatori ekonomik “INTRAST” SH.P.K. si palë e pakënaqur me datë 26.07.2023 ka parashtruar Kërkesë për Rishqyrtim në AK- Komunën e Gjilanit kundër Njoftimit mbi Vendimin e AK-së të dt. 21.07.2023 përkitazi me aktivitetin e prokurimit me titull: “Sinjalizimi Horizontal, Vertikal dhe pajisjeve rrugore në komunën e Gjilanit” me Nr. të Prok: 651-22-10313-2-1-1, me arsyetimin se AK i ka eliminuar për arsye se nuk e ka vazhduar validitetin e ofertës.

Autoriteti Kontraktues, Komuna e Gjilanit përmes Zyrtarit Përgjegjës të Prokurimit, konform nenit 108/A paragrafi 6 të LPP-së ka shqyrtuar vlefshmërinë e pretendimeve të evidentuara në Kërkesën për Rishqyrtim të OE ankues “INTRAST” SH.P.K

Me rastin e vlerësimit preliminar të Kërkesës për Rishqyrtim të parashtruesit, Autoriteti Kontraktues duke u udhëhequr nga parimi i drejtësisë dhe transparencës e ka vlerësuar si të afatshme¹ kërkesën e juaj dhe nga personi i autorizuar sipas paragrafit 3.2 të nenit 108/A të LPP-së dhe nenit 60.2 – b) të Rregullorës për Prokurim Publik Nr.001./2022. Kurse nga ana tjetër ka gjetur se OE ankues nuk mund ta ketë statusin e palës me interes në kuptim të nenit 4 paragrafi 1.26 të LPP-së dhe Informatës së publikuar nga OSHP me dt.02.02.2023, sepse nuk mund të dëshmojë interes material nga rezultati i këtij aktiviteti për arsye se nuk e ka vazhduar sigurimin e tenderit sipas kërkesës me shkrim të AK-së të dt. 19.05.2023 dhe për shkak se nuk i ka plotësuar kriteret kualifikuese që kanë të bëjnë me nenin 69 të LPP-së, rrjedhimisht të specifikuara në kërkesën 2 dhe kërkesën 4 të dosjes së tenderit lidhur me kapacitetin teknik dhe profesional.

Andaj, duke u mbështetur nga parimet e vlerësimit objektiv, transparent dhe të barabartë, AK shqyrtoi në mënyrë meritore (*in meritum*) pretendimin e OE ankues të parashtruar në kërkesën për rishqyrtim në relacion me administrimin e të gjitha fakteve, provave dhe shkresave të kësaj lënde, dhe pas vlerësimit të tyre në pikpamje të drejtë dhe të ligjshme, gjen se:

- **Kërkesa për Rishqyrtim është e pabazuar dhe pa ndikim për vendosje ndryshe.**

- Konstatimet e AK-së bazuar në faktet dhe rrethanat e rastit –

Pretendimi i OE ankues: *Sipas përshkrimit të deklaratës mbi faktet dhe argumentet e paraqitura, keni pohuar se, kinse AK ju ka eliminuar për arsye se nuk e keni vazhduar validitetin e ofertës sipas kërkesës së AK-së të datës 19.05.2023 përmes platformës e-prokurimi. Sipas pohimit të theksuar në kërkesë thuhet se oferta e juaj ka validitet për 200 ditë nga data e dorëzimit të tenderit që ka qenë me datë 06.03.2023.*

Përgjigja e AK në pretendimin e OE ankues:

Autoriteti Kontraktues Komuna e Gjilanit, sipas vlerësimit të pavarur të tij konstaton se, **pretendimi i OE ankues është i pabazuar** në asnjë fakt apo provë relevante dhe bazë ligjore në

¹ Pavarësisht faktit se në kuadër të legjislacionit sekondar ka një një kontradiktë dhe konflikt lidhur me kalkulimin e kohës së fillimit të afatit ligjor midis nenit 60 paragrafi 1, pika b) me nenin 42 paragrafi 7 shkronja a) e Rregullorës Nr. 001/2022 për Prokurim Publik. Sipas nenit 60.1 pika b) përcaktohet se dita e publikimit të njoftimit është dita zero (0) ndërsa sipas nenit 42.7 shkronja a) përcaktohet se nëse njoftimi publikohet ditën e premte, afati kohor për parashtrim të ankesës fillon ditën e premte. Kështu që, sipas nenit 42.7 – a) kërkesa e juaj i bie se është e jashtëafatshme.

relacion me pretendimet e pohuara lidhur me arsyen e eliminimit të tij sipas vendimit të AK-së.

Sipas dosjes së tenderit në pikën 13.1 dhe 13.2 të FTD-së është përcaktuar depozitimi i sigurisë së tenderit në shumën 3,400.00€ për një periudhë valide prej 120 ditë nga afati i fundit për dorëim të tenderit. Ndërsa në pikën 21.1 të FTD-së është përcaktuar kërkesa për OE që periudha e vlefshmërisë së tenderit të jetë prej 90 ditë nga afati i fundit për dorëzim të tenderit.

Për shkak të situatave të justifikueshme dhe/ose të veçanta kur vonesa të papritura shfaqen, duke nënkuptuar se lënda ishte në rivlerësim dhe procesi i rivlerësimit nuk mund të finalizohet brenda afatit të periudhës së validitetit të tenderëve, AK para datës së skadimit të validitetit dhe sigurimit të tenderëve në mënyrë që të vazhdoj me vlerësimin e ofertave, me datën 19.05.2023 ka kërkuar me shkrim (përmes sistemit e-prokurimi) nga të gjithë tenderuesit që të zgjasin afatin e vlefshmërisë së ofertave për nëntëdhjetë (90) ditë si dhe sigurisë së tenderit për 30 ditë nga data skadimit të sigurimit të tenderit të dorëzuar para hapjes së ofertave. Në kontekst të kërkesës të theksuar si më sipër, ka qenë në mundësinë dhe diskrecionin e OE pjesëmarrës që deri me datën 23.05.2023 në ora 12:00 nëse dëshirojnë dhe vendosin të zgjasin validitetin dhe sigurinë e tenderit.

Kërkesës të AK-së për zgjatjen e validitetit dhe sigurisë së tenderit ju kanë përgjigjur para skadimit të afatit të përcaktuar të gjithë OE pjesëmarrës me përjashtim tuajin si OE që nuk jeni përgjigjur. Andaj, duke qenë se nga ana e juaj nuk është zgjatur afati i validitetit dhe sigurisë së tenderit, bazuar në këto rrethana AK ka vepruar sipas nenit 30 paragrafi 6 të RRPP nr. 001/2022 duke e refuzuar në këtë fazë si të papërgjegjshëm tenderin e juaj.

Kështu që, në kontekstin e fakteve dhe rrethanave të theksuara si më sipër, përgjegjësia ka qenë e juaja se a dëshironi të vazhdoni sigurinë e tenderit sipas kërkesës së AK-së meqenëse validitetin e keni pasur për 200 ditë (në kundërshtim me kërkesën e dosjes së tenderit). Prandaj në asnjë rrethanë nuk mund të justifikoheni për refuzim të tenderit të juaj si të papërgjegjshëm i cili ka ardhur si rezultat i dëshirës për mos zgjatjen e sigurisë së tenderit apo dështimit për shkaqe të papërgjegjshmërisë së juaj si OE. **Andaj kjo pikë ankimore është e pabazuar.**

Për më tepër, bazuar gjendjen e fakteve dhe rrethanave nga vlerësimi paraprak i AK-së i datës 07.04.2023 në relacion me tenderin e juaj, AK vlerëson njejtë për refuzimin e tenderit të juaj si të papërgjegjshëm sepse nuk i ka plotësuar kriteret kualifikuese që kanë të bëjnë me nenin 69 të LPP-së, rrjedhimisht të specifikuara në kërkesën 2 dhe kërkesën 4 të dosjes së tenderit lidhur me kapacitetin teknik dhe profesional.

Prandaj, bazuar në kontekstin e të gjitha fakteve, arsyeve dhe gjendjes faktike që u përshkrua më sipër, AK vlerëson se OE ankues nuk mund të konsiderohet palë me interes në kuptim të paragrafit 1.26 të nenit 4 të LPP-së sipas të cilit përcaktohet se palë e interesuar është personi që mund të dëshmojë interes material nga rezultati i aktivitetit të prokurimit. Në këtë kuptim si dhe në analogji edhe me dispozitat tjera të LPP-së, të drejtat themelore, procedurale dhe mjetet juridike në dispozicion mund të vihen në lëvizje vetëm nga palët e interesuara duke ju referuar përkufizimit të dhënë në nenin 4 paragrafi 1.26 të LPP-së.

- Përfundim -

Autoriteti Kontraktues pas shqyrtimit të pretendimeve të paraqitura në kërkesën për rishqyrtim të “INTRAST” SH.P.K dhe duke u bazuar në analizën e të gjitha fakteve dhe shkresat e kësaj lënde, sipas vlerësimit të pavarur dhe objektiv konstaton se pretendimet e evidentuara në kërkesën e juaj janë të pabazuara në tërësi dhe duke qenë se mbi bazën e fakteve të përshkruara si më sipër nuk e keni statusin e palës me interes në kuptim të nenit 4 paragrafi 1.26 të LPP-së, kërkesa e juaj refuzohet e pabazuar, respektivisht hedhet si e palejuar.

Në këtë mënyrë, AK vlerëson se procesi i rivlerësimit, ekzaminimit dhe krahasimit të tenderëve është zhvilluar në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme konform kriterëve kualifikuese dhe vlerësuese të dosjes së tenderit dhe zbatimit në mënyrë të drejtë të dispozitave përkatëse të nenit 59.4, nenit 60 paragrafi 1.1 si dhe ashtu siç parashihet me nenin 1, 6 dhe 7 të LPP-së.

Duke u bazuar në arsyet e dhëna më lart, Autoriteti Kontraktues në kuptim të nenit 108/A në paragrafin 10.1 të LPP-së dhe duke u bazuar në nenin 63 paragrafi 1.1 pika (a) të lidhur me nenin 60.3 pika e) dhe nenin 62.1 pika (d) të Rregullorës Nr. 001/2022 për Prokurim Publik, ka vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.


Kujtim Bajrami
Zyrtar Përgjegjës i Prokurimit

Kopje:

- Operatorit Ekonomik ankues SHPK. “INTRAST”;
- Zyrës së Kryetarit të Komunës;
- Te gjitha palëve të interesuara;